



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

THIRRJE PUBLIKE

Komuna e Podujevës përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Podujevë ju bënë thirrje publike për aplikim të gjitha klubeve, shoqatave sportive që janë të regjistruara në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Podujevës, që janë dëshmuar në zhvillimin dhe masovizimin e sportit ndër të rinjët dhe zhvillojnë aktivitetet dhe garat sipas programit të tyre për vitin kalendarik 2020 .

Kërkesa duhet të përmbanë:

1. Qëllimin e kërkesës/projektit
2. Përshkrimin e aktiviteteve të projektit/plan programit të vitit kalendarik 2020 me koston e tyre
3. Kosto që kërkohet nga Komuna
4. Rezultatet e arritura në vitin paraprak.

Kërkesës duhet ti bashkëngjiten edhe këto dokumente:

1. Të jenë të regjistruara në DKRS
2. Çertifikata e OJQ-së
3. Çertifikata e numrit fiskal të klubit, shoqatës
4. Letërnjoftimi i bartësit të xhirollogarisë
5. Vërtetimi / dëshmia e bankës në emër të subjektit i cili aplikon (Klubi, shoqata)
6. Të dhënat e aplikuesit: Telefoni, email adresa .

- ✓ Formulari i projekt/propozim
- ✓ Formulari i propozimi buxhetit
- ✓ Formulari i deklaratës së partneritetit
- ✓ Formulari i deklaratës mbi financim të dyfishtë

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **25.000 €**

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo klub ose shoqatë (OJQ) është **400 €**, ndërsa shuma maksimale është **4.000 €**.

Afati i fundit për aplikim është 10 ditë pune, nga data e 04.09.2020 deri me 18.09.2020.

Dokumentet e kompletuara dërgohen në zyrën pritëse nr.14 kati i parë në komunën e Podujevës në zarfe të mbyllura.

Formularët mund të merret në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe mund të shkarkohen online në faqen e Komunës së Podujevës.

<https://kk.rks-gov.net/podujeve/>

Vetëm projektet që janë në përputhshmëri me kriteret për aplikim të cekura më lartë, do të procedohen për shqyrtim nga komisioni i përzgjedhur.

Vërejtje:

Nuk do të merren në shqyrtim:

1.Klubet/shoqatat të cilat nuk janë përgjegjur kërkeses së DKRS-së për plotësimin e formularit të sportit Komunal 2020 .

2. Konkursit të cilët nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar .



Drejtore

Donika Sfishta



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Thirrje publike

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt propozimeve të OJQ-ve për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe rinore si : **festivaleve, aktivitete rinore, ekspozita, manifestime** etj.

1. **Drejtoria për kulturë, rini dhe sport në komunën e Podujevës**, u bën thirrje të gjitha **OJQ-ve**, të regjistruara në Komunën e Podujevës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushat kulturore dhe rinore të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në organizimin e **festivaleve, aktiviteteve rinore, ekspozita dhe manifestime kulturore, në komunën e Podujevës**.
2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekt propozimet për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe rinore.
3. OJQ- të mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në organizimin e fushave kulturore dhe rinore, përmes aktiviteteve si me poshtë:
 - **Festivalet**
 - **Aktivitete rinore**
 - **Ekspozita**
 - **Manifestime**
 - **Promovimi i vullnetarizmit**
 - **Fuqizimi i organizatave rinore** (*seminare, trajnime, kurse për aftësimin e të rinjëve etj.*).
 - **Edukimi jo-formal** (*stimulimi i të miturve për edukim dhe arsim*).
 - **Integrimi i grupeve rinore dhe atyre të marginalizuara**
4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **15.000**
5. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo shoqatë (OJQ) është **300 €**, ndërsa shuma maksimale është **3.000 €**.
6. **Afati i fundit për aplikim është 10 ditë pune, nga data e 04.09.2020 deri me 18.09.2020.**

OJQ-të mund të aplikojnë vetëm me një projekt.

Periudha e zbatimit deri në muajin dhjetor.

Kërkesës duhet ti bashkëngjiten këto dokumente :

- Kopja e letërnjoftimit për parashtruesin e kërkesës
 - Certifikata e numrit të regjistrimit të OJQ-ës;
 - Letërnjoftimi i bartësit të xhirollogarisë;
 - Vërtetimi /dëshmia e bankës të subjektit i cili aplikon
 - Të dhënat e aplikuesit: telefoni, email adresa
- Formulari i projekt-propozimit
 - Formulari i propozim buxhetit
 - Formulari i deklaratës së partneritetit;
 - Formulari i deklaratës mbi financimin e dyfishtë

Formularët mund të merren në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe të shkarkohen online në faqen e Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>

OJQ-të duhet po ashtu të kenë të kryer obligimet financiare në menyrë transparente, sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës.

Dokumentet e kompletuara dërgohen në zyrën pritëse nr.14 kati i parë në komunën e Podujevës në zarfe të mbyllura.

Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit, vlerësimit dhe dhënia e fondeve të aplikuesve janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Drejtore
Donika Sfishta

